

UDHËZIM
Nr.90/1, datë 16.1.2006

PËR PROCEDURËN E ORGANIZIMIT TË KOMISIONIT TË LICENCIMIT TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, të pikës 13 dhe 14 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.564, datë 12.8.2005 “Për licencimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”,

UDHËZOJ:

1. Komisioni i licencimit të ofruesve të shërbimeve dhe përkujdesjes shoqërore funksionon si organ konsultativ i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

2. Komisioni i licencimit shqyrton:

a) aplikimet për pajisjen me licencë dhe rilicencim nga ofruesit e shërbimeve shoqërore publike dhe jopublike;

b) propozimet e Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës së Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore për ofruesit që nuk zbatojnë standardet e shërbimeve shoqërore.

3. Dokumentacioni i aplikimeve për pajisjen me licencë për ofrimin e shërbimeve sociale, që përgatitet nga Shërbimi Social Shtetëror, si dhe propozimet e Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës së Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, regjistrohen në protokollin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

4. Drejtoria e Shërbimeve Sociale informon me shkrim kryetarin e komisionit të licencimit, mbi aplikimet për licencim dhe propozimet e Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës së Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, nëse ka të tilla, duke i propozuar datën për mbledhjen e komisionit. Kryetari i komisionit vendos për datën e mbledhjes së komisionit, duke pasur në konsideratë afatin e përcaktuar në pikën 9 të vendimit nr.564, datë 12.8.2005 “Për licencimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”, si dhe njofton me shkrim anëtarët e komisionit.

5. Drejtoria e Shërbimeve Sociale i paraqet kryetarit të komisionit të licencimit kopjen origjinale të dokumentacionit për licencim, ndërsa anëtarëve kopjen fotokopje 7 ditë përpara datës së caktuar për mbledhje.

6. Dokumentacioni për licencim përbëhet nga:

a) dokumentacioni që ka paraqitur aplikuesi;

b) vlerësimi i Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës së Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore.

7. Komisioni i licencimit mblidhet kur është e pranishme shumica e anëtarëve të tij. Pasi bën vlerësimin e kërkesës për licencim, dokumentacionit të çdo aplikanti, në përfundim të çdo mbledhjeje vendos t’i propozojë Ministrit:

a) miratimin për pajisjen me licencë;

b) refuzimin për pajisjen me licencë;

c) miratimin për rinovimin e licencës;

d) refuzimin për rinovimin e licencës;

e) miratimin ose refuzimin e propozimeve të Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës së Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore kur ka të tilla.

8. Anëtarët e komisionit të licencimit shprehen për çdo aplikues dhe çdo propozim. Për rastet kur licenca ose propozimi refuzohet, komisioni paraqet me shkrim argumentimin përkatës.

9. Çdo anëtar komisioni ka të drejtë të shprehë mendimin e tij me shkrim, në rastet kur ka mendime të ndryshme mes anëtarëve për vendimin e marrë. Këto mendime pasqyrohen në dokumentacionin që i dërgohet për miratim ose refuzim Ministrit.

10. Ministri, pasi është njohur me materialin propozues të Komisionit, vendos për miratimin ose refuzimin e tij. Në rastet kur miratohet pajisja me licencë, Drejtoria e Shërbimeve Sociale përgatit licencën përkatëse, e cila firmoset nga Ministri. Në rastet kur nuk miratohet pajisja me licencë, Drejtoria e Shërbimeve Sociale njofton zyrtarisht aplikantin për refuzimin e pajisjes me licencë, për pezullim ose heqje licence duke përmendur në njoftim argumentet dhe afatin kohor të ankimit. Ky njoftim firmoset nga Ministri.

11. Në rastin e miratimit nga Ministri, të propozimeve të Inspektoratit të Ndihmës Ekonomike, Pagesës së Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, atëherë Drejtoria e Shërbimeve

Sociale njofton subjektin përkatës brenda 7 ditëve.

12. Licenca do të ketë formatin, që i bashkëngjitet këtij udhëzimi.

13. Licenca merret në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale nga aplikanti ose nga një përfaqësues i tij. Për të tërhequr licencën, i interesuari duhet të paraqesë faturën për pagesën e tarifës përkatëse.

14. Udhëzimi nr.1321/10, datë 3.12.2003 “Për licencimin e personave juridikë privatë, përfshirë edhe OJF-të për ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE
TË BARABARTA
Koço Barka

